



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Janar, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Arsimit, në vazhden e punëve dhe detyrave të shumta në funksion të proceseve arsimore, gjatë muajit janar të vitit 2020, ka arritur me sukses dhe në kohë optimale t'i realizon punët dhe detyrat, të parapara sipas planit të veprimit, si dhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje e vazhdueshme e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja/mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurimi i buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;

- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkoll[]), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Organizimi dhe mbajtja e garës "Olimpiada matematike";
- Organizimi i garës "Fizikanët e rinj";
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizohen takime dhe punëtori për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-së në shkolla;
- Ekipi në fjalë hulumton trendet e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Hartimi i planit të veprimit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);

- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatri, nutricionistit e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijeve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendren Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkollë;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin e furnizimi me inventar;
- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin e furnizimit me kabinete;
- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin e furnizimi me material higjienik;
- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin e furnizimi me drurë dekorativë;
- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin “Hapja e bunarëve në oborret e shkollave”;

- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin e furnizimi me pajisje kuzhine;
- Përgatitja për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin e furnizimit me perde;
- Furnizimi i nxënësve të nivelit të arsimit fillor me kiflet;
- Furnizimi i nxënësve të nivelit fillor me qumësht;
- Furnizimi me pelet i disa institucioneve edukativo-arsimore;
- Furnizimi me naftë i disa institucioneve edukativo-arsimore;
- Përcjellja dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance;

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë.

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët, sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke e përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, këshilluese, speciale dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit janar të vitit 2020 kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar **6 vizita informuese** dhe **1 vizitë speciale** në shkollën fillore “Mitrush Kuteli”;

- **Vlerësimi i dosjeve të mësimeve për KK**

Për të vlerësuar gjendjen e implementimit të kurrikulës së re dhe zbatueshmërinë e saj në praktikë nga mësimeve të shkollave tona, në koordinim me përfaqësuesit e MASHT-it, gjatë muajit janar 2020, jemi dakorduar së bashku për fillimin e procesit të vlerësimit të dosjeve të tyre, të cilët e kanë përfunduar trajnimin e KKK-së dhe janë duke e zbatuar atë në praktikë.



Në komunën e Prishtinës këtë trajnim gjatë muajit korrik 2019 e kanë përfunduar 529 mësimeve, drejtues të shkollave, pedagogë dhe psikologë. Andaj, për vlerësimin dhe dosjet e tyre ekipi ka përgatitur dhe ndërtuar formularin e vlerësimit sipas kërkesave dhe standardeve të kërkuara, që garanton një vlerësim objektiv dhe real të njohurive të mësimeve rreth punëve dhe detyrave të realizuar mbi KKK-së.



Mandej, për vlerësimin e dosjeve të edukatoreve/mësimeve, kemi caktuar personat kompetentë dhe profesionalë, të cilët në koordinim me përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit e kanë realizuar këtë proces, ku vlerësimi i dosjeve ka qenë përcaktues për certifikimin e mësimeve, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

Kështu që, në Komunën e Prishtinës, më 6 janar 2020, ka filluar procesi i vlerësimit të dosjeve të mësimdhënësve dhe është finalizuar më 10 janar të vitit 2020. Nga vlerësimi i realizuar mbi dosjet e 330 mësimdhënësve komisionet profesionale kanë konstatuar se mësimdhënësit kanë shënuar progres të theksuar në raport me vitet paraprake në implementimin dhe zbatimin në praktikë të kurrikulës së re. Pra, i gjithë ky progres ka rezultuar pas një pune dhe përkushtimit të madha të Drejtorisë së Arsimit, shkollave dhe në veçanti nga mbështetja profesionale e Ekipit profesional në nivel komune, të cilën në mënyrë të planifikuar dhe permanente kanë organizuar takime-punëtori të shumta me mësimdhënësit, duke i mbështetur dhe ndihmuar ata me këshilla profesionale në zgjidhjen e çdo sfide të paraqitur;



- **Gara “Fizikanët e rinj”**

Më 18 janar 2020, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Shoqatën e Fizikanëve të Kosovës, organizuan garën “Fizikanët e rinj” në nivel komune. Gara u zhvillua me nxënësit e klasave IX, X, XI dhe të XII, nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar.



Në garën “Fizikanët e rinj”, secila shkollë u përfaqësua me nxënës që kanë treguar rezultate të larta në garën në nivel shkolle. Ndërsa, nxënësit që do të shënojnë rezultate të mira në nivel komune, do ta përfaqësojnë Komunën e Prishtinës në nivel vendi, më 01 shkurt 2020, garë kjo që do të mbahet në Fakultetin e Shkencave Matematikore-Natyrore (Departamentin e Fizikës), të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, nxjerrjes në pah të shkathtësive dhe kompetencave të arritura nga nxënësit në shkencën e fizikës, identifikimin e talenteve të reja dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.



Drejtoria e Arsimit, në kontekst të zhvillimit, ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka ndër marrë veprime konkrete në shumë dimensione, që garantojnë progres në ngritje të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke përmirësuar infrastrukturën shkollore, pajisjen e shkollave me kabinate, laboratorë dhe mjete të ndryshme dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, në mënyrë që të kemi një mësimdhënie cilësor dhe të jemi në hapë me trendët dhe zhvillimet ndërkombëtare.

- **Olimpiada e Matematikës**

Më datë 25 janar 2020, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Shoqatën e Matematikanëve të Kosovës, organizuan garën “Olimpiada matematike”, garë e cila ka për qëllim nxjerrjen në pah të shkathtësive dhe kompetencave të nxënësve të arritura në shkencën e matematikës, identifikimin e talenteve



të ri dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.

Pjesëmarrës në këtë garë ishin 59 nxënës të klasave IX-XII, nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore publiko dhe private, ku në këtë garë secila shkollë u përfaqësua me nxënës që treguar rezultate të larta në nivel shkolle.

Nxënësit që do shënojnë rezultate të mira në nivel komune, do të përfaqësojnë Komune e Prishtinës në nivel vendi, pastaj edhe në nivel ndërkombëtar, nga 08 - 18 korrik 2020, e që këtë vit do të mbahet në St. Petersburg, në Rusi.



Nxënësit e komunës së Prishtinës edhe në garat në nivel ndërkombëtar, deri tani kanë arritur suksese dhe rezultate të larta;

- Gjatë muajit janar, Drejtorja e Arsimit në koordinim me Zyrën e Bashkimit Evropian, kanë organizuar trajnimin për zhvillimin profesional të 220 mësimdhënësve, për mendim kritik, të nivelit fillor dhe parafillor të shkollave fillore: "Ismail Qemali", "Hasan Prishtina", "Meto Bajraktari", "Zenel Hajdini", "Hilmi Rakovica", "Naim Fashëri" dhe "Afrim Gashi";
- Gjatë muajit janar janë realizuar takimet bashkëpunuese në mes mësimdhënësve të shkollave bashkëpunuese. Në këto takime të planifikuara u trajtan çështje të ndryshme rreth implementimit dhe zbatimit të kurrikulës së re dhe u përgatitën planet mujore (janar - shkurt - mars 2020), planet të cilat u përgatitën nga mësimdhënësit, në bashkëpunim me trajnerin e fushës përkatës të KK-së;
- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund të muajit kanë përgatitur raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentorua nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa, Drejtorja e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit, dhe u ka përgatitë formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj.

- **Marrëveshje bashkëpunimi**

Drejtorja e Arsimit dhe Federata e Rugby-it të Kosovës, kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të implementimit të Projektit pilotues për prezantimin e Rugby-it në shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Prishtinës. Ky plan do të zhvillohet për një periudhë prej 6 muajsh, duke filluar nga 20 janari deri më 31 qershor 2020.

Federata e Sportit Shkollor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës, do të komunikojnë dhe përzgjedhin shkollat fillore ku

fillimisht do të bëhet prezantimi në Rugby. Përparësia do të jepet për shkollat që tashmë kanë qendër sportive shtëpie.

Nga secila shkollë e përzgjedhur do të zgjidhet një mësues që do të angazhohet në organizimin e trajnimeve Rugby brenda shkollës dhe zhvillimin e Klubit Rugby brenda shkollave (22 - 23 janar).

KRF në bashkëpunim me DKA dhe Federatën e Sportit Shkollor, do të organizojnë takimin e parë me mësuesit, ku do të ndajnë planin e zhvillimit për Rugby në kuadër të komunës së Prishtinës. Gjatë këtij takimi secili mësues informohet me rolin dhe përgjegjësinë, me objektivat e planit.

- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave, mbi rezultatet dhe suksesin e arritur në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2019-2020, në të tri nivelet e arsimit parauniversitar;
- Përgatitjet dhe organizimi për realizimin e Testit të arritshmërisë, si caktimi i qendrave testuese, caktimi i administruesve të cilët do të administrojnë testin dhe përcjellja e të dhënave në MASHT;
- Përgatitjet për organizimin e testit ndërkombëtar PISA;
-
- Analizë dhe vlerësim i suksesit të nxënësve të të tri niveleve të arsimit parauniversitar, për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2019-2020;
- Vlerësim të suksesit të nxënësve për secilën lëndë mësimore;
- Procesimi i të dhënave për stafin menaxhues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimi joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi në nivel komune ka operuar sipas planifikimeve të parapara për vlerësimin dhe adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet përkatëse. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues 4 nxënës. Të gjithë nxënësit e vlerësuar janë rekomanduar që mësimet t'i vijojnë në shkolla të rregullta.
- Realizimin e praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale, gjatë muajit janar është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm, kjo është si pasojë e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra, është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale është determinuese, në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale;
- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet

theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;

- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhune apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtorja merr masa të menjëhershme komfor legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullores komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtar për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Takime me prindër të shkollave të ndryshme;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit janar;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kifle dhe qumësht;
- Furnizimi i vazhdueshëm i të gjitha institucioneve me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Janë përcjellë të gjitha projektet te Zyra e prokurimit për të vazhduar me procedura të tjera;
- Janë furnizuar institucionet edukativo-arsimore me lëndë djegëse për ngrohje;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtorja juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkolle), mësimitdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimitdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me

palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, janar 2020

Buxheti i shpenzuar dhe Alokuar janar-2020				
Kategoria Eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - Obligim	Mbetje -S=
Paga	1,558,545.68	1,558,545.68	-	-
Komunali	63,333.34	-	-	63,333.34
10-MSH	253,371.60	167,058.58	-	86,313.02
21-MSH	-	-	-	-
Subvencione	41,666.67	-	-	41,666.67
Donacione				-
FB-21-Kapitale				-
FB-22-Kapitale				-
Totali:	1,916,917.29	1,725,604.26	-	191,313.03

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit janar ka realizuar mbi 112 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit janar të vitit 2020, janë realizuar takime me:

- Përfaqësues të MASHT-së;
- rektorin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- përfaqësuesit e BIRN;
- kolegjiun e arsimit-Asociacionin e Komunave të Kosovës;
- përfaqësuesit e Komisionit Evropian;
- përfaqësuesit e KUR "Prishtina";

- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së.

4.1.1. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit janar 2020, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit janar 2020, janë pranuar gjithsej 304 lëndë, prej tyre të miratuara janë 18 lëndë, të refuzuara 15 lëndë, të pezulluara 21 lëndë, të anuluar 1 lëndë dhe në proces janë edhe 247 lëndë për paga jubilarë.

6. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara.

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafi profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjor në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimit të punëve dhe detyrave;
- Implementimi i Kurrikulës së re.

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurimi i buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Gara për pikturën më të mirë;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatimi i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;

- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Krijimi i ekipit për identifikimin e nevojave të shkollave për teknologji arsimore;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtorë, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;

- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrah NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit komunal për vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijesimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimit nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Përgatitja dhe dërgimi në prokurim i projektit “Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra”;
- Përgatitja dhe dërgimi në prokurim i projektit “Furnizimi i me rekuizita sportive”;
- Përgatitja dhe dërgimi në prokurim i projektit “Furnizimi i institucioneve arsimore me material didaktik”;
- Përgatitja dhe dërgimi në prokurim i projektit “Furnizimi i institucioneve arsimore me material didaktik etj”.

10. TË TJERA

Shënoni çështje të tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.